**VENDIM**
**Nr.365, datë 14.6.2006**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.108, DATË 11.2.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT, TË FUNKSIONIMIT DHE PAGAT E PUNONJËSVE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.8610, datë 17.5.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave", të ndryshuar, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006", me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.108, datë 11.2.2005 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 7, lidhja nr.1 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Në pikën 7.1 vlera "… 9306 (nëntë mijë e treqind e gjashtë) lekë…" zëvendësohet me vlerën "… 10 050 (dhjetë mijë e pesëdhjetë) lekë…".

2. Të gjitha dispozitat, që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2006, të përballohen nga fondet e planifikuara për reformën dhe rritjen e pagave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2006.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

Lidhja nr.1

| | | PAGA MUJORE | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| EMËRTIMI | KATEGORITË | PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË) | | | SHTESA E POZICIONIT |
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| | | Paga e grupit (PG) | Shtesa për vjetërsi (SHK) | Shtesa për kualifikim (SHP) | Shtesa për pozicion (SHP) lekë |
| Drejtor i Përgjithshëm | II-a | 10.050 | 2% | 0 | 97 713 |
| Zv/drejtor i Përgjithshëm | II-b | 10.050 | 2% | 0 | 80 342 |
| Drejtor | III-a/1 | 10.050 | 2% | 0 | 49 942 |
| Përgjegjës sektori | III-b | 10.050 | 2% | 0 | 43 428 |
| Specialist | IV-a | 10.050 | 2% | 0 | 32 571 |
| | IV-b | 10.050 | 2% | 0 | 21 714 |